



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

Integrimi ndërkombëtar i Zyrës Kombëtare të Auditimit





Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

INTEGRIMI NDËRKOMBËTAR I ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT

Botuar nga:
Zyra Kombëtare e Auditimit

TABELA E PËRMBAJTJES

Fjala e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës	7
Hyrje	9
1.ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT: HISTORIK I SHKURTËR	11
Historiku	12
Mandati	12
Vizioni, Misioni dhe Vlerat e ZKA-së	13
Vlerat e ZKA-së	14
Orientimet strategjike të ZKA-së	15
Kompetenca profesionale	16
Aktivitetet audituese	17
2.PROJEKTET ME DONATORË DHE PARTNERË	19
Bashkimi Evropian	20
Bashkëpunimi me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Suedisë	21
Banka Botërore	21
USAID	21
Projektet e tjera	21
3.AKTIVITETET NDËRKOMBËTARE TË ZKA-SË	23
AKTIVITETET NDËRKOMBËTARE TË ZKA-së	24
Pjesëmarrja në ngjarje ndërkombëtare	24
Bashkëpunimi bilateral	30
Vizitat dhe takimet e tjera zyrtare me homologë	32
4.ANËTARËSIMI I ZKA-SË NË INTOSAI	35
Procesi i anëtarësimit të ZKA-së në INTOSAI	36
Rëndësia dhe përfitimet e ZKA-së nga anëtarësimi në INTOSAI	39
ZKA-ja mirëpritet në familjen INTOSAI-t nga anëtarët e saj	40

SHTOJCAT	49
Shtojca A: INTOSAI	50
Misioni dhe qëllimet	50
Vizioni	50
Standardet e funksionimit të auditimit të sektorit publik të lëshuara nga INTOSAI	51
FOTO GALERIA	53

Lista e Shkurtesave

AP	Auditori i Përgjithshëm
AFROSAI	Organizata Afrikane e Institucioneve Supreme të Auditimit
ARABOSAI	Organizata Arabe e Institucioneve Supreme të Auditimit
ASOSAI	Organizata Aziatike e Institucioneve Supreme të Auditimit
BE	Bashkimi Evropian
BB	Banka Botërore
CAROSAI	Organizata e Institucioneve Supreme të Auditimit të Karaibeve
ECA	Gjykata Evropiane e Auditorëve
ECOSOC	Këshilli Ekonomik dhe Social i Kombeve të Bashkuara
EUROSAI	Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Auditimit
EVP	Edukimi i Vazhdueshëm Profesional
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
ISA	Institucioni Suprem i Auditimit
NP	Ndërmarrje Publike
OLACEFS	Organizata e Institucioneve Supreme të Auditimit të Amerikës Latine dhe Karaibeve
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
PASAI	Organizata e Institucioneve Supreme të Auditimit të Pacifikut
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit



FJALA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM TË KOSOVËS



Besnik Osmani

Anëtarësimi me të drejta të plota i Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës në Organizatën Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit përbën suksesin më të madh në historinë e auditimit të jashtëm, të sektorit publik të Republikës së Kosovës.

Vendimi për pranimin e Zyrës Kombëtare të Auditimit nga Bordi Drejtues i INTOSAI-t, dëshmon vlerat e kësaj organizate, për t'u ofruar mundësi të barabarta të gjitha shteteve, pa dallim, që t'u përgjigjen sfidave në rritje për auditimin e sektorit publik në vendet e tyre, duke ndarë përvojat dhe praktikatat dhe duke përkrahur njëri-tjetrin në adresimin e tyre.

Ky vendim e bën të mundur shkëmbimin e dijes dhe përvojave në mënyrë që të zhvillojmë më tutje kapacitetet tona institucionale, për të zbatuar detyrat dhe përgjegjësitë me transparencë, integritet dhe në mënyrë të përgjegjshme. Po ashtu, e bën të mundur për Kosovën si tërësi, që në mënyrë më të efektshme të adresojë sfidat për menaxhimin efektiv të parasë publike dhe të forcojë qeverisjen e mirë në vend.

E konfirmoj me plot bindje se Zyra Kombëtare e Auditimit është plotësisht e aftë të merr përsipër obligimet e të qenit anëtare me të drejta të plota dhe do të japë kontributin e saj në ruajtjen dhe forcimin e vlerave dhe parimeve udhëzuese të INTOSAI-t.

Sikurse deri më tani, Zyra Kombëtare e Auditimit, do të mbetet institucion i pavarur i sektorit publik, duke rritur cilësinë e punës së saj dhe duke i ofruar Kuvendit e publikut raporte kredibile dhe relevante.

Dua t'i falënderoj institucionet e Kosovës, të cilat që nga fillimi ma besuan udhëheqjen e këtij procesi, i respektovan me përpikëri të gjitha veprimet dhe patën durimin të presin rezultatin final.

Shpreh mirënjohjen e thellë për Institucionet Supreme të Auditimit anëekënd botës, shumë individë, miq të ZKA-së, vendorë e të huaj nga fusha e së drejtës ndërkombëtare, administratës publike e diplomacisë, që sa herë kishim nevojë, në mënyrë krejtësisht vullnetare kanë ndarë dijen dhe përvojën e tyre për të na këshilluar e ndihmuar në procesin e anëtarësimit.

Ndihem i privilegjuar që pata fatin të punoj me bashkëpunëtorë të shkëlqyeshëm të Zyrës Kombëtare të Auditimit, të cilët me integritet të lartë e profesional dhanë kontribut të pazëvendësueshëm në përmbushjen e këtij misioni.

Suksesi ju dedikohet juve.

Faleminderit të gjithëve!

HYRJE

Zhvillimi institucional i Zyrës Kombëtare të Auditimit u shoqërua me një përvojë unike, ngaqë u themelua nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe u menaxhua nga stafi ndërkombëtar për më shumë se një dekadë, deri te transferimi i të gjitha kompetencave te autoritetet e Republikës së Kosovës. Auditori i Përgjithshëm kosovar u emërua në mars të vitit 2016 nga Kuvendi i Kosovës.

Dy vjet më vonë, duke konsideruar se ishin plotësuar të gjitha kushtet dhe kërkesat që burojnë nga Statuti i INTOSAI-t, si dhe duke llogaritur në kapacitetet e plota të Zyrës Kombëtare të Auditimit, për të marrë përsipër të drejtat dhe përgjegjësitë që përshkruhen për anëtarët e saj, më datën 8 maj 2018, Auditori i Përgjithshëm paraqiti kërkesën formale për anëtarësim pranë Sekretariatit të INTOSAI-t, në Vjenë.

Me vendimin e Bordit Drejtues, Zyra Kombëtare e Auditimit u pranua si anëtare me të drejta të plota e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI), Vendimi u bë i plotëfuqishëm nga 1 janari i vitit 2020.

Ky rezultat kulminant është kurorëzim i punës së jashtëzakonshme të personelit të Zyrës Kombëtare të Auditimit, institucioneve të Kosovës dhe përkrahjes së pakursyer të Institucioneve Supreme të Auditimit anë e kënd botës.

INTOSAI, si organizatë “ombrellë” për Institucionet Supreme të Auditimit ka për qëllim t’u ofrojë mbështetje të ndërsjellë, përmes nxitjes së bashkëpunimit dhe shkëmbimit të ideve, njohurive dhe përvojave, si dhe të veprojë si një “zë publik” i ISA-ve në nivel global. Mbi këtë bazë, ishte jo vetëm e arsyeshme, por e domosdoshme, që ZKA-ja të anëtarësohet me të drejta të plota në këtë organizatë, në mënyrë që të përfitojë nga praktikat e mira ndërkombëtare dhe për të promovuar qeverisjen e mirë në Kosovë.

Prej themelimit e deri te anëtarësimi në INTOSAI, ZKA-ja ka përfituar në mënyrë të vazhdueshme nga bashkëpunimet bilaterale me Institucionet Supreme të Auditimit dhe nga ndihma e Bashkimit Evropian. Kjo ka ndikuar që në mënyrë të vazhdueshme të ketë rritje të kapaciteteve të veta dhe të mund t’i ofrojë Kuvendit të Kosovës dhe publikut raporte cilësore e në pajtim me Standardet Ndërkombëtare për Institucionet Supreme të Auditimit.

Ky publikim, sado që përfshin disa nga zhvillimet e rëndësishme të ZKA-së deri te anëtarësimi në INTOSAI, nuk mëton të sjellë një informacion të plotë dhe të detajuar për të gjitha aktivitetet dhe sfidat e këtij rrugëtimi apo të rezultateve të punës së ZKA-së.

Publikimi u dedikohet si shenjë mirënjohjeje të gjithë individëve dhe institucioneve, që u angazhuan dhe përkrahën ZKA-në në kauzën e saj legjitime, për t’u integruar denjësisht në familjen globale të Institucioneve Supreme të Auditimit.



Personeli i ZKA-së: Ceremonia e ndarjes së certifikatave, 22 nëntor 2016.



1

ZYRA KOMBËTARE E
AUDITIMIT:
HISTORIK I SHKURTËR

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), si Institucion Suprem i Auditimit (ISA) kryen auditimin e jashtëm të sektorit publik në Republikën e Kosovës. Mandati dhe detyrat e Auditorit të Përgjithshëm janë përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës 05/L-055.

HISTORIKU

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm¹ u themelua nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Në nëntor të vitit 2003, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), emëroi Auditorin e parë të Përgjithshëm të Kosovës, Inga-Britt Ahlenius. Atëkohë, sapo ishin krijuar institucionet e para të përkohshme të Kosovës dhe udhëhiqeshin bashkërisht nga zyrtarë vendorë e ndërkombëtarë.

Duke qenë njëri prej institucioneve më të rëndësishme në vend, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm u udhëhoq për më shumë se 10 vjet nga një auditor ndërkombëtar, që në zbatimin e mandatit mbështetej nga personeli vendor.

Në vitin 2006, UNMIK-u e emëroi Auditor të Përgjithshëm, Linda Casella-n. Më pas, në vitin 2008, pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës me 17 shkurt 2008, institucioni i Auditorit të Përgjithshëm (AP) u integrua në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe njëkohësisht u miratua Ligji nr. 03/L-075 për "Themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës".

Në vitin 2009, Lage Olofsson, u emërua si Auditori i tretë i Përgjithshëm i Kosovës. Ai u emërua nga Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian në Kosovë (njëkohësisht Përfaqësues Civil Ndërkombëtar dhe udhëheqës i Zyrës Civile Ndërkombëtare në Kosovë).

Auditori i parë i Përgjithshëm Kosovar, Besnik Osmani u emërua në mars të vitit 2016 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, me nominimin e Presidentes së Kosovës, Atifete Jahjaga, pas një procesi të hapur dhe konkurrues. Vetëm pak muaj më vonë, në qershor të vitit 2016, Kuvendi shpalli Ligjin e ri nr. 05/L-055 për AP-në dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, duke zëvendësuar kështu ligjin e vjetër. Me këtë aktivitet përmbylli procesin e kosovarizimit të institucionit dhe kompletimit të kornizës ligjore.

MANDATI

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e përcakton Auditorin e Përgjithshëm (AP)² si institucionin më të lartë të kontrollit ekonomik dhe financiar në Republikën e Kosovës, i cili ushtron funksionet në bazë të ligjit, duke qenë i pavarur në aspektin funksional, financiar dhe operacional në ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësi të tij.

¹ Me Ligjin 05/L-055 për AP-in dhe ZKA-në, institucioni u riemërua "Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA)".

² Për qëllime të këtij publikimi, institucionit të Auditorit të Përgjithshëm do t'i referohemi edhe si Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA).

Zyra Kombëtare e Auditimit i raporton Kuvendit të Kosovës dhe ka të drejtë të kontrollojë të gjitha aktivitetet, programet dhe projektet financiare, administrative dhe të tjera të menaxhuara nga institucionet publike, përfshirë procesin dhe të ardhurat nga shitja e aseteve, privatizimeve dhe koncesioneve.

ZKA-ja, kryen auditime të rregullsisë së Buxhetit të Kosovës, të organizatave buxhetore dhe të Ndërmarrjeve publike, si dhe auditime të performancës.

Auditori i Përgjithshëm dhe ZKA-ja ushtrojnë mandatin në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

ZKA-ja është e pajisur me të gjitha aktet e brendshme, doracakët dhe letrat e punës për auditimet financiare, të pajtueshmërisë, të performancës dhe të auditimeve në fushën e Teknologjisë dhe Informacionit. he Informacionit.

VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT E ZKA-SË

VIZIONI

Institucion i besueshëm i auditimit, që përmirëson qeverisjen në sektorin publik, në interes të qytetarëve

MISIONI

Përmes auditimeve cilësore fuqizon llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare

VLERAT E ZKA-SË

PAVARËSIA

Pavarësia nënkupton që i gjithë procesi i auditimit t'i nënshtrohet vetëm kërkesave të standardeve profesionale dhe të jetë jashtë ndikimit të palëve të treta. Pavarësia është elementi kryesor për të siguruar besimin e publikut dhe të Kuvendit të Kosovës, duke u ofruar atyre informacione të besueshme dhe të paanshme.

PROFESIONALIZMI

ZKA-ja udhëhiqet në veprimtarinë e saj audituese nga standardet profesionale të INTOSAI-t dhe nga praktikat më të mira të vendeve të Bashkimit Evropian.

INTEGRITETI

ZKA-ja angazhohet për mishërimin e vlerave më të mira etike, profesionale dhe morale. Veprimtaria e auditimit kryhet jashtë çdo konflikti interesi.

TRANSPARENCA

ZKA-ja është organizatë e hapur dhe bën publike të gjitha aktivitetet e saj të rëndësishme. Po ashtu, i ofron publikut të gjerë informacionin e përfituar nga auditimi, në përputhje me rregullat ligjore dhe standardet profesionale. ZKA-ja angazhohet që të promovojë transparencën edhe në subjektet e audituara, si një element i qeverisjes së mirë.

ORIENTIMET STRATEGJIKE TË ZKA-SË

Duke qenë e vëmendshme për zhvillimet dhe sfidat e së ardhmes dhe me qëllim të përmbushjes së misionit e ambicieve institucionale, Zyra Kom-bëtare e Auditimit ka hartuar Planin Strategjik 2018-2021. Plani paraqet një mënyrë të re, më të avancuar të punës, e cila është më e qartë në qëllimet dhe objektivat strategjike, më e integruar dhe i ofron mundësinë ZKA-së që t'i përgjigjet pritjeve të palëve vendore dhe atyre ndërkombëtare.

Me këtë plan janë përcaktuar tri qëllime kryesore:

PAVARËSIA DHE STANDARDET PROFESIONALE

Të përmbushë misionin kushtetues e ligjor,
duke kryer auditime relevante në përputhje me SNISA

1

QEVERISJA DHE ZHVILLIMI I KAPACITETEVE INSTITUCIONALE

Të zhvillojë dhe të forcojë kapacitetin institucional për
të mbështetur auditimin dhe qeverisjen korporative

2

KOMUNIKIMI, NDIKIMI DHE INTEGRIMI

Të zhvillojë dhe të mirëmbajë marrëdhënie të mira me
palët e jashtme, duke promovuar auditimin, rritur
ndikimin dhe duke u integruar në organizatat globale
dhe rajonale të ISA-ve

3

KOMPETENCA PROFESIONALE

Pasuria kryesore e Zyrës Kombëtare të Auditimit janë burimet njerëzore. Qëllimi kryesor në konceptin e menaxhmentit është forcimi i qasjes korporative dhe investimi në zhvillimin e kompetencës profesionale të personelit.

Zyra Kombëtare e Auditimit gjatë gjithë këtyre viteve ka bërë përpjekje maksimale për mbajtjen dhe motivimin e punonjësve ekzistues, dhe prurje të resurseve të reja, përmes politikës së rekrutimit të bazuar në meritë.

Trajnimi dhe zhvillimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore mbetet një ndër prioritetet kryesore të ZKA-së, pasi që me zhvillimin e këtyre kapaciteteve kontribuohet në cilësi më të mirë, profesionalizëm më të lartë dhe qasje më të organizuar ndaj punës. Fokusi i ZKA-së në vazhdimësi është i drejtuar në edukimin e vazhdueshëm profesional (EVP), ku përmes trajnimeve të brendshme dhe atyre të jashtme synohet të zhvillohen njohuritë dhe kompetenca e secilit punonjës në ZKA.

Aktualisht, ZKA -ja nga 170 të punësuar, numëron 141 auditorë, prej të cilëve 54% janë të licencuar në nivelin më të lartë Auditor Senior, 27% janë në nivelin Auditor dhe 19% janë Auditor Junior. Në këtë numër përfshihen auditorët e rregullsisë me 75%, auditorët e performancës dhe të TI-së me 18% dhe pjesa tjetër e përkrahjes profesionale në auditim me 7%.

Në planin afatgjatë, ZKA-ja synon të zgjerojë gamën e trajnimeve të ofruara, pasi që me rastin e anëtarësimit në INTOSAI janë shtuar mundësitë e përfitimeve nga trajnimet më specifike dhe të specializuara, në bashkëpunim me institucionet simotra të auditimit.



Diskutimi me stafin për Planin Strategjik 2018 -2021, korrik 2018




Puna në grupe, Konferenca Vjetore e ZKA-së, tetor 2019


AKTIVITETET AUDITUESE

- ✓ Çdo vit, Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës harton dhe dorëzon në Kuvend dhe te subjektet e audituara mbi 100 raporte të auditimit të rregullsisë dhe të performances
- ✓ Numri i auditimeve të rregullsisë është rritur për rreth 25% në krahasim me sezonin auditues 2015/16
- ✓ Janë trefishuar auditimet e performancës në krahasim me vitin 2016
- ✓ Auditimi i Ndërmarrjeve publike (NP) ka filluar në sezonin auditues 2016/17 me 4 NP. Numri i auditimeve të NP-ve është trefishuar në sezonin auditues 2019/2020


Auditimet e rregullsisë
(2015/16-2019/20)




Auditimet e NP-ve
(2015/16-2019/20)



Auditimet e performancës
(2015/16-2019/20)





2

PROJEKTET ME
DONATORË DHE
PARTNERË

BASHKIMI EVROPIAN

Bashkimi Evropian dhe Institucionet Supreme të Auditimit, përmes projekteve kanë dhënë kontribut të madh dhe mbështetje të vazhdueshme në konsolidimin dhe avancimin e kapaciteteve të ZKA-së, në zbatimin e strategjive, zhvillimin e qasjes së auditimit dhe kapaciteteve organizative e profesionale. Po ashtu, ZKA-ja në vazhdimësi është përkrahur dhe ka bashkëpunuar edhe me institucionet ndërkombëtare dhe organizatat donatore në Kosovë.

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve përmes promovimit të të mësuarit dhe shkëmbimit të njohurive, ZKA-ja mban kontakte dhe ka zhvilluar marrëdhënie të mira me ISA-të, në veçanti me ato të vendeve të Evropës dhe më gjerë.

Përmes projekteve të Binjakëzimit, ZKA-ja ka pasur mundësi që të avancohet në auditimin e jashtëm dhe përmes këtij procesi të ndihmohet dhe përkrahet Kosova në integritet evropian. Nga viti 2012, në mënyrë të pandërprerë janë realizuar katër projekte të binjakëzimit, të cilat janë financuar nga Bashkimi Evropian dhe janë zbatuar apo janë në zbatim nga ekspertë të Institucioneve Supreme të Auditimit të Mbretërisë së Bashkuar, Holandës, Skocisë, Estonisë, Polonisë, Kroacisë, Çekisë, Letonisë, Lituanisë dhe të Portugalisë. Të gjitha këto ISA kanë kontribuar në mënyrë konkrete në fusha të ndryshme dhe janë pjesë e suksesit të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Në mënyrë të përmbledhur, angazhimi i tyre ka dhënë rezultate për planifikimin strategjik, forcimin e kapaciteteve institucionale, rritjen e ndikimit të ZKA-së përmes komunikimit të intensifikuar me qytetarët, Parlamentin e palët tjera të interesit, si dhe përditësimin e doracakëve të auditimit (financiar dhe të pajtueshmërisë) e të letrave të punës, në përputhje me legjislacionin nacional dhe SNISA-t.



Inaugurimi i Projektit të Binjakëzimit 1, me ISA Polak: nga e majta në djathtë: Besnik Osmani (AP Kosovë), Riccardo Serri (Zyra BE, Kosovë), Krzysztof Kwiatkowski (AP Polak), Arvita Zyferi (NAP Kosovë), Wiesław Kurzyca (ISA Poloni), Qerkin Morina (NAP Kosovë), Augustin Kubik (ISA Poloni), nëntor 2017.

BASHKËPUNIMI ME ZYRËN KOMBËTARE TË AUDITIMIT TË SUEDISË

Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës ka bashkëpunim afatgjatë dhe të frytshëm në kuadër të bashkëpunimit biletaral me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Suedisë. Bashkëpunimi i inauguruar në vitin 2011, përmes Marrëveshjes së Bashkëpunimit ka ndihmuar në zhvillimin e kapaciteteve të ZKA-së, për të përmbushur mandatin e saj dhe për t'u bërë një institucion i qëndrueshëm suprem i auditimit, i cili vepron në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe praktikatat e mira.

Ky është projekti më gjithëpërfshirës zhvillimor i zbatuar në ZKA dhe fokusohet në zhvillimin e kapaciteteve në auditimet e performancës, lidërsip, menaxhim të burimeve njerëzore, komunikim dhe planifikim strategjik. Të gjitha aktivitetet në kuadër të projektit janë të financuara nga partneri suedez.

Përmes këtij projekti është mundësuar veçmas zhvillimi i kapaciteteve në auditimet e performancës dhe si rrjedhojë, ZKA-ja për çdo vit publikon një numër të konsiderueshëm të auditimeve nga fushat e ndryshme të veprimtarisë ekonomike e administartive në Kosovë. Projekti, poashtu ka përkrahur edhe jetësimin e auditimeve paralele, si një përvojë e veçantë e cila i ka kontribuar shumë edhe bashkëpunimit rajonal midis Institucioneve Supreme të Auditimit.

BANKA BOTËRORE

Prej vitit 2013 deri më 2019, Zyra Kombëtare e Auditimit është përkrahur nga Banka Botërore. Projektet e realizuara me përkrahjen e Bankës Botërore, qëllim kryesor kishte ngritjen e kapaciteteve të auditorëve për të analizuar në mënyrë kritike sistemet e prokurimit dhe efikasitetin e përdorimit të burimeve publike. Si rezultat i kësaj mbështetje financiare, nën mentorimin e ekspertëve ndërkombëtarë është bërë i mundur themelimi dhe zhvillimi i kapaciteteve të Departamentit të Auditimit në fushën e Prokurimit Publik dhe janë publikuar katër raporte të auditimit në fusha të rëndësishme të prokurimit publik, duke përfshirë të gjitha fazat e prokurimit nga planifikimi e deri te menaxhimi i kontratave publike.


Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në këto auditime ka ndikuar ndjeshëm në përmirësimin e menaxhimit të parasë publike dhe rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të prokurimit publik në Kosovë, veçmas pas dizajnit dhe zbatimit të E-prokurimit.

USAID

Projekti "Komunitat transparente, efektive dhe llogaridhënëse", i financuar nga USAID-i, i cili ka filluar të zbatohet në vitin 2017 dhe ende është në zbatim e sipër, e ka ndihmuar ZKA-në për zhvillimin e politikave të nevojshme, për themelimin e Njesisë Kundër Mashtrimit dhe Korrupsionit. Në kuadër të projektit është trajnuar personeli i ZKA-së për identifikimin dhe raportimin e këtyre rasteve pranë organeve përkatëse të sistemit të drejtësisë. Po ashtu, janë zhvilluar Udhëzuesit përkatës për menaxhimin e rasteve të ndjeshme të identifikuar gjatë procesit të auditimit. Projekti është i shtrirë në një numër të caktuar të komunave, të cilat ndihmohen në zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit.

PROJEKTET E TJERA

Organizatat dhe donatorët e tjerë që kanë ndihmuar dhe përkrahur ZKA-në përmes projekteve të ndryshme janë: Ambasada e Britanisë së Madhe në Kosovë; Qeveria Gjermane përmes GIZ-it; Ambasada e Norvegjisë në Kosovë; Ambasada e Zvicrës; Ambasada e Mbretërisë Holandeze, etj.



Pjesëmarrësit e Kongresit 22 të INTOSAI-it, dhjetor 2016



3

AKTIVITETET
NDËRKOMBËTARE
TË ZKA-SË

AKTIVITETET NDËRKOMBËTARE TË ZKA-SË

Aktivitetet ndërkombëtare të ZKA-së janë intensifikuar gjatë viteve të fundit, me qëllim të pjesëmarrjes në aktivitete të rëndësishme të organizatave globale e rajonale të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe integritit formal në këto organizata. Në këtë sesion janë përfshirë vetëm disa prej aktiviteteve të rëndësishme të AP-së dhe të personelit të ZKA-së në kuadër të bashkëpunimeve bilaterale e multilaterale me organizatat simotra.

PJESËMARRJA NË NGJARJE NDËRKOMBËTARE

Kongresi i 22-të i INTOSAI-t

Abu Dhabi, Emiratet e Bashkuara Arabe (Dhjetor 2016) - Auditori i Përgjithshëm i Kosovës, Besnik Osmani, me bashkëpunëtorë mori pjesë në punimet e Kongresit të 22-të të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI). Kongresi u mbajt në Abu Dhabi të Emirateve të Bashkuara Arabe nga data 7-11 dhjetor 2016 dhe kjo ishte hera e parë që Auditori i Përgjithshëm i Kosovës ftohet të merr pjesë në një ngjarje të tillë. Temë kryesore e Kongresit ishte “Si mund të kontribuojë INTOSAI në ‘Agjendën e OKB-së 2030 - për zhvillim të qëndrueshëm, qeverisje të mirë dhe forcimin e luftës kundër korrupsionit?”.



Takimi i AP-it të Kosovës, Besnik Osmani me Presidentin e INTOSAI-t, Dr. Harib Saeed Al Amimi, në Abu Dhabi, dhjetor 2016.



Delagacioni i ZKA-së në Kongresin e 22 të INTOSAI-it, nga e majta në të djathtë: Artan Venhari, Zv/AP-it, Besnik Osmani, AP-i i Kosovës dhe Ilir Salihu, këshilltar i AP-it për performancë institucionale, dhjetor 2016.

Kongresi i 10-të i EUROSAT-t

Stamboll, Turqi (Maj 2017) - Zyra Kombëtare e Auditimit ftohet për herë të parë që të merr pjesë si mysafire në punimet e Kongresit të 10-të të Organizatës Evropiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAT), që u mbajt më 22-25 maj të vitit 2017, në Stamboll të Turqisë.



Pjesëmarrësit e Kongresit të 10-të të EUROSAT-it, maj 2017.



Nga e majta në të djathtë: AP-i i Kosovës Besnik Osmani, udhëheqësja e Kabinetit të AP-it Qendresa Mulaj dhe Zv/AP-it, Ilir Salihu, në punimet e Kongresit të 10-të të EUROSAT-t, maj 2017.

Takimi vjetor i Komitetit të INTOSAI-it për Ngritje të Kapaciteteve

Tokio, Japoni (Korrik 2019) - Delegacioni i ZKA-së mori pjesë në takimin vjetor të Komitetit të INTOSAI-it për Ngritje të Kapaciteteve, i cili u mbajt prej 1 deri më 4 korrik të vitit 2019, në Tokio të Japonisë. Në margjinat e këtij takimi, Auditori i Përgjithshëm, zhvilloi takime të shumta me delegacionet e SAI-ve të vendeve anëtare të Bordit Drejtues të INTOSAI-t dhe zhvilloi takime me homologët nga Institucioni i Auditimit të Japonisë.



Pjesëmarrësit e Takimit të Komitetit të INTOSAI-it për Ngritje të Kapaciteteve, korrik 2019.

Takimi i 15-të i Grupit Punues së EUROSAT-t për Auditimet e Mjedisit

Shqipëri, (Tetor 2017) - Auditori i Përgjithshëm i Kosovës, Besnik Osmani, mori pjesë në takimin e 15-të të Grupit Punues të EUROSAT-t për Auditimet e Mjedisit, i cili u mbajt më 18 tetor të vitit 2017, në Shqipëri. Në këtë takim morën pjesë rreth 75 përfaqësues nga 26 Institucione Supreme të Auditimit.



Pjesëmarrësit e Takimit 15-të të Grupit Punues të EUROSAT-t për auditimet e mjedisit, tetor 2017.

Takimi i Komitetit të Kontaktit dhe Rrjetit të ISA-ve të vendeve kandidate dhe kandidate potenciale të BE-së dhe ECA-s

Luksemburg, (Tetor 2017) - Në selinë e Gjykatës Evropiane të Llogarive në Luksemburg u mbajt takimi i Komitetit të Kontaktit dhe Rrjetit të Institucioneve Supreme të Auditimit të vendeve kandidate dhe kandidate potenciale të Bashkimit Evropian dhe ECA-s. Në këtë takim mori pjesë edhe Auditori i Përgjithshëm i Kosovës, Besnik Osmani. Ai, së bashku me bashkëpunëtorë mori pjesë edhe në ceremoninë zyrtare me rastin e shënimit të 40 vjetorit të themelimit të ECA-s, me ftesë të Presidentit të Gjykatës Evropiane të Auditorëve, Klaus – Heiner Lehne.



Pjesëmarrësit e Takimit të Rrjetit, tetor 2017.

Takimi i Dytë i Aleancës së Auditorëve

Paris, Francë (Mars 2019) - Zëvendës-Auditori i Përgjithshëm i Kosovës, Ilir Salihu mori pjesë në Takimin e Dytë të Aleancës së Auditorëve, të mbajtur më 22 mars të vitit 2019, në selinë qendrore të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), në Paris të Francës. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të 74 shteteve, nga organizata të ndryshme, përfshirë institucionet supreme të auditimit, organizatat e auditorëve të brendshëm, si dhe organizatat rajonale dhe globale të auditorëve. Salihu udhëhoqi njërin nga sesionet e këtij takimi me temën “Përshtatja me ndryshimin dhe përdorimi i teknologjive të reja për auditim”.



Nga e majta në të djathtë: Martin Rubenstein (Kanadë), Ilir Salihu (Zv/AP i Kosovës) dhe Magdalena Cordero (ECA).

Konferenca ndërkombëtare dhe shënimi i 15-të vjetorit të ZKA-së

Prishtinë, Kosovë (tetor 2018) - Me 4 tetor 2018, Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës ka shënuar 15-të vjetorin e themelimit si Institucion Suprem i Auditimit i Republikës së Kosovës. Me këtë rast, nga 1 deri me 5 tetor 2018 janë organizuar një sërë aktivitete me tematikë të zhvillimit profesional, humanitar dhe festiv. Aktiviteti kryesor dhe më i rëndësishëm ishte konferenca ndërkombëtare "Roli dhe ndikimi i Institucioneve Supreme të Auditimit në rikthimin e besimit të publikut në sektorin publik".



Pjesëmarrësit e Konferencës ndërkombëtare, tetor 2018.

Në konferencë morën pjesë përfaqësues të lartë nga EUROSAT, Gjykata Evropiane e Auditorëve, ISA-të të Turqisë, Çekisë, Suedisë, Polonisë, Bullgarisë, Uellsit, Kroacisë, Arabisë Saudite, Malit të Zi, Shqipërisë, Maqedonisë. Po ashtu, pjesëmarrës në këtë konferencë ishin edhe përfaqësues nga SIGMA, si dhe zyrtarë të lartë nga Kuvendi dhe institucione tjera publike nga vendi. Konferenca ka zhvilluar punimet në dy panele me theks në "Ndikimin e auditimit të performancës për qeverisje më të mirë" dhe se "Si ISA-të duhet të demonstrojnë relevancë të vazhdueshme për shoqërinë, duke kryer auditime të bazuara në rrezik". Folës kryesor në konferencë ishin Gene Dodaro, Auditor i Përgjithshëm i SHBA-ve dhe Rimantas Šadžius, anëtar i Gjykatës Evropiane të Auditimit.

BASHKËPUNIMI BILATERAL

Marrëveshjet e Bashkëpunimit

Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës ka marrëveshje bashkëpunimi me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Suedisë, të Turqisë, të Çekisë, të Uellsit, të Shqipërisë e të Maqedonisë Veriore. Marrëveshjet kanë për qëllim shkëmbimin e përvojave institucionale dhe e ndihmojnë ZKA-në për forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve institucionale në zhvillimin e aktiviteteve specifike si: Auditime të Performancës; Auditime të Rregullsisë (financiare dhe të pajtueshmërisë); Menaxhim të Burimeve Njerëzore; Komunikim dhe Planifikim Strategjik.

Më poshtë janë të ilustruara me fotografi Marrëveshjet e Bashkëpunimit me ISA-të.



1. Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Zyren Kombëtare të Auditimit të Suedisë në Prishtinë: Zv/AP i Suedisë, Magnus Lindell dhe A-iP i Kosovës, Besnik Osmani, gusht 2017.
2. Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Zyren Kombëtare të Auditimit të Çekisë: Milosllav Kala, AP-i i Çekisë dhe Besnik Osmani, AP i Kosovës, prill 2019.
3. Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Zyren Auditimit të Uellsit (Britani e Madhe): Huw Vaughan Thomas, AP-i i Uellsit dhe Besnik Osmani, AP i Kosovës, maj 2017.
4. Nënshkrimi i Protokollit të Bashkëpunimit me Kontrollin e Lartë të Shtetit të Shqipërisë. Kryetari i KLSH-së, Bujar Leskaj dhe Auditori i i Përgjithshëm, Besnik Osmani, Prishtinë, nëntor 2016.
5. Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Zyren e Revizorit Kryesor Shtetëror të Republikës së Maqedonisë së Veriut.. Në fotografi, Naser Ademi, u.d. i Revizorit Kryesor Shtetëror të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Besnik Osmani, AP i Kosovës, Prishtinë, shkurt 2019.
- 6 & 7 Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Zyren Kombëtare të Auditimit të Turqisë: Seyit Ahmet Baş, President i Institucionit Suprem të Auditimit të Turqisë dhe Besnik Osmani, AP i Kosovës, prill 2018.



VIZITAT DHE TAKIMET E TJERA ZYRTARE ME HOMOLOGË

Vizita në Institucionin Suprem të Auditimit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (GAO)

Uashington, SHBA (Mars 2018) - Auditori i Përgjithshëm, Besnik Osmani, me bashkëpunëtorë realizoi vizitën e parë zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku u pritë nga Auditori i Përgjithshëm i SHBA-ve, Gene Dodaro.



Nga e majta në të djathtë: Vlora Mehmeti, N/AP Kosovë, Besnik Osmani, AP-i i Kosovës, Gene Dodaro (AP-i i SHBA-ve) dhe Qendresa Mulaj (Udhëheqëse e Kabinetit të AP-së së Kosovës), SHBA, mars 2018.

Vizita në Gjykatën Evropiane të Auditorëve (ECA)


Luksemburg, (Nëntor 2019). Auditori i Përgjithshëm i Kosovës, Besnik Osmani, i shoqëruar nga Zëvendësi i tij, Ilir Salihu, zhvilluan një vizitë zyrtare në Gjykatën Evropiane të Auditorëve (ECA) në Luksemburg, ku u takuan me Kryetarin e ECA-së, Klaus Hainer Lehne.



Nga e majta në të djathtë: Besnik Osmani, AP-i i Kosovës, Klaus Hainer Lehne, Kryetari i ECA-së dhe Ilir Salihu, Zv/AP Kosovë, Luksemburg, nëntor 2019.

Vizita në Institucionin Shtetëror të Auditimit të Emirateve të Bashkuara Arabe

Abu Dhabi, Emiratet e Bashkuara Arabe (Shtator 2019). Auditori i Përgjithshëm i Kosovës zhvilloi vizitë zyrtare në Institucionin Shtetëror të Auditimit të Emirateve të Bashkuara Arabe, ku u takua me Presidentin e Institucionit Shtetëror të Auditimit të Emirateve të Bashkuara Arabe, Dr. Harib Saeed Al Amimi, njëherësh edhe Kryesues i Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI).




Nga e majta në të djathtë: Fitim Haliti, drejtor i departamentit të Auditimit, Qëndresa Mulaj, udhëheqëse e kabinetit të AP-it, Besnik Osmani, AP-i i Kosovës dhe Dr. Harib Saeed Al Amimi (Presidenti i INTOSAI-t dhe ISA EBA), shtator 2019.

Vizita e Presidentit të EUROSAT-t në Kosovë

Prishtinë, Kosovë (Prill 2018). Auditori i Përgjithshëm i Kosovës, Besnik Osmani, priti në vizitë zyrtare dyditore, Seyit Ahmet Baş, President i Organizatës Evropiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAT) dhe Institucionit Suprem të Auditimit të Turqisë, me bashkëpunëtorë.



Nga e majta në të djathtë: Vlora Mehmeti (ZKA), Imri Semetishti (ZKA), Qendresa Mulaj (ZKA), Abdullah Simsek (ISA Turqi), Besnik Osmani (AP Kosovë), Seyit Ahmet Baş (Presidenti i EUROSAT-t dhe ISA Turqi), Feyzullah Okumus (ISA Turqi), Valbon Bytyqi (ZKA), Prishtinë, prill 2018.



4

ANËTARËSIMI I
ZKA-SË NË INTOSAI

PROCESI I ANËTARËSIMIT TË ZKA-SË NË INTOSAI

Procesit të anëtarësimit të ZKA-së në INTOSAI, siç u theksua më lart, i paraprinë një mori aktivitete, arritjesh profesionale, bashkëpunimesh e projekteve të shënuara për më shumë se një dekadë e gjysmë. Pas një procesi të gjatë promovues në arenën ndërkombëtare, më 8 maj të vitit 2018 Zyra Kombëtare e Auditimit aplikoi për anëtarësim në INTOSAI.

Kërkesa u ekzaminua nga Sekretariati i Përgjithshëm i INTOSAI-t dhe më pas u paraqit në Bordin Drejtues të kësaj organizate gjatë takimit të 71-të, të mbajtur në 15 dhe 16 nëntor 2018 në Moskë të Rusisë. Pas shqyrtimit të aplikimit, Bordi Drejtues vendosi të shtyjë vendimin ndaj kërkesës së ZKA-së deri në Takimin e 72, i cili ishte planifikuar të mbahej në shtator 2019, sërisht në Moskë. Shtyrja, siç u konstatua nga bordi u bë për të siguruar informata shtesë rreth aplikimit të ZKA-së.

Gati një vit më vonë, Bordi Drejtues i INTOSAI-t, në Mbledhjen e 72-të të Bordit Drejtues, i cili u mbajt me 23 dhe 24 shtator mori vendim për pranimin e Zyres Kombëtare të Auditimit në INTOSAI, me të drejta të plota. Një ditë pas, për vendimin e Bordit u informua edhe Kongresi i 23-të i INTOSAI-t, i cili u mbajt poashtu në Moskë. Gjatë këtij Kongresi, ISA i Federatës Ruse mori kryesimin e INTOSAI-t deri në Kongresin e 24-të, që pritet të mbahet pas tri vjetësh në Brazil.

Pas anëtarësimit, Auditori i Përgjithshëm i Kosovës, Besnik Osmani e njoftoi zyrtarisht Presidentin dhe Kryeministrin e Kosovës për vendimin dhe një ditë më vonë përmes një konference për media edhe publikun kosovar.

Lajmi për anëtarësim u përcoll me telegrame urimi nga shumë Institucione Supreme të Auditimit e organizata tjera ndërkombëtare dhe nga misio-net diplomatike në Republikën e Kosovës, të cilat u dërguan në adresë të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Aplikimi për anëtarësim në INTOSAI

Përkthim jozyrtar i Letrës për aplikim



Republika e Kosovës
Zyra Kombëtare e Auditimit

Prishtinë, 6 maj 2018

Nr. Referencë: *0254/1*

Organizata Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI)

z. Mergit Eraker, Sekretar e Përgjithshme

(INTOSAI) Qendër Administrativ
Rr. Kuvendi
Drejtimi Administrativ 2
11011 Prishtinë
Kosovë

Kërkesë për përfshirje si anëtar me të drejtë të plotë në INTOSAI

Shënim: Juaj,

Në emër të Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës, kam nderin t'ju dërgoj këtë kërkesë për përfshirje në Auditim të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës si anëtar me të drejtë të plotë në INTOSAI bazuar në nenin 2, paragrafi 1 të statutit të INTOSAI-t. Po ashtu, në emër të Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës, deklaroj se Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është i gatshëm të pranohet dhe marrë pjesë në të gjitha të drejtat dhe obligimet që dalin nga statusi i anëtarit me të drejtë të plotë në INTOSAI.

Nënen 2, paragrafi 5(a) i statutit të INTOSAI parashihet se përfshirja në INTOSAI si anëtar me të drejtë të plotë është e hapur për të gjitha Institucionet Supreme të Auditimit të të gjitha vendeve që janë anëtarë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara ose të ndonjë Agjencie të Specializuar të saj.

Që nga 29-prillor 2008, Republika e Kosovës është bërë shtet anëtar i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMI) dhe Bankës Botërore (Bankë Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, Qendra Ndërkombëtare për Zhvillim e Komerciale të Investimeve, Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim, Korporata Ndërkombëtare Financiare, Agjencia për Garancimin e Investimeve Multilaterale), të cilat janë agjenci të specializuara të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik dhe financiar në Republikën e Kosovës. Auditori i Përgjithshëm ushtron funksionin e tij bazuar në ligj si dhe është i pavarur nga ana funksionale, financiare dhe operative në ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të tij. Auditori i Përgjithshëm ka mandatin të përfshijë Kosovën në anëtarë ndërkombëtare për plotësi që lidhen me auditimin, përfshirë aderimin në organizatat ndërkombëtare profesionale, për vëmendjen tuaj, dispojitat përkatëse të Kushtetutës së Republikës së Kosovës për Auditim të Përgjithshëm dhe legjislacionin përkatës i janë bashkëngjitur kësaj kërkesë.

Marrë parasysh se si the më lart, është e qartë se Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës i plotëson kërkesat për përfshirje në INTOSAI si anëtar me të drejtë të plotë, siç parashihet në nenin 2, paragrafi 1 të statutit të INTOSAI-t. Prandaj, ju ftoj që të shprehni kësaj kërkesë të Bordit Drejtues i INTOSAI-t për të shprehur atë vopis nënë 2, paragrafi 7 të statutit të INTOSAI-t.

Ju falem për përkrahjen tuaj me të mirë.

Beulah Osman

[Signature]
Auditor i Përgjithshëm

Bashkëngjitur:

- Ligji nr. 015/0-012 për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Organizatat e Bankës Botërore
 - Dokumentet lidhur me anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar, dhe
 - Dokumentet lidhur me anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Organizatat e Bankës Botërore.
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës
- Ligji nr. 015/0-015 për Auditim të Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

Rr. Masine Kokolari nr.87, 1000, Prishtinë, Republika e Kosovës
Telefoni: +381 (0) 38 60 60 04 1012
www.zka-ksa.org



RËNDËSIA DHE PËRFITIMET E ZKA-SË NGA ANËTARËSIMI NË INTOSAI

Të qenit anëtar i Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INOSAI), në veçanti nënkupton të jesh në gjendje që të përfitosh nga vlerat ndërkombëtare, duke shkëmbyer përvoja nga praktikat e globale për të zhvilluar auditimin e sektorit publik.

Aktivitetet e INTOSAI-t janë të përqëndruara në forcimin e aftësive të anëtarëve të saj dhe ofrimin e përfitimeve për Institucionet Supreme të Auditimit (ISA). Për më tepër, pjesëmarrja e Zyrës Kombëtare të Auditimit drejtpërdrejt në organet, komitetet dhe grupet e INTOSAI-t, duke përfshirë aktivitetet trajnuese, nënkupton gjithashtu njohjen e standardeve, udhëzimeve, praktikave dhe kornizave profesionale e etike

Anëtarësimi në INTOSAI është gjithashtu një parakusht për anëtarësim në EUROSAI, një organizatë evropiane rajonale e auditimit, që përbëhet nga të gjitha ISA-t e vendeve evropiane, përveç Kosovës.

ZKA-ja mund të përfitojë drejtpërdrejt nga shumë programe të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t, të cilat synojnë ndërtimin e kapaciteteve, luftën kundër korrupsionit, forcimin e bashkëpunimit të Institucioneve Supreme të Auditimit dhe Parlamenteve, aplikimin e sistemeve të IT-së në aktivitetet e auditimit, etj. Të qenit anëtar i INTOSAI-t do të ndihmojë gjithashtu rreth bashkëpunimit me ISA-të e vendeve fqinje. Gjithashtu, do të ndihmojë në intensifikimin e bashkëpunimit me ISA-t e vendeve fqinje.

Për më tepër, duke qenë anëtare e organizatave të mësipërme, Zyra Kombëtare e Auditimit mund të përfitojë edhe nga programet e Gjykatës Evropiane të Auditorëve (ECA). Nga praktika e deritanishme, në rastet kur ZKA-ja ka përfituar nga ato programe, ka qenë thjesht nga vullneti i mirë i shprehur nga Presidenti i ECA-s, që të përfshijë personelin e Zyrës Kombëtare të Auditimit në programet e saj.

Duke qenë se përfitimet janë të shumta e të gjithanshme, përfundimisht mund të themi se me anëtarësimin në INTOSAI për Zyrën Kombëtare të Auditimit është hapur një kapitull i ri.

ZKA-JA MIRËPRITET NË FAMILJEN INTOSAI-T NGA ANËTARËT E SAJ

Në sesionin vijues janë publikuar letrat e pranuaras enkas për këtë publikim nga Auditorët e Përgjithshëm dhe nga disa prej personaliteteve të përfshira në procesin e anëtarësimit të Zyres Kombëtare të Auditimit të Kosovës në INTOSAI. Përmbajtja e tyre është publikuar e plotë.

Me anëtarësimin në INTOSAI, ZKA-së do t'i mundësohet shkëmbimi i njohurive dhe përvojave me ISA-të simotra



Dr. Harib ALAMIMI

*President i ISA-s së Emirateve të
Bashkuara Arabe
ish-President i INTOSAI-t
Kryesues i Bordit të drejtorëve të
INTOSAI-t (2017-2019)*

“Gjatë dy dekadave të fundit, bota ishte dëshmitare e nevojave në rritje të shërbimeve të sektorit publik. Kjo, pastaj i rriti edhe pritshmëritë e Institucioneve Supreme të Auditimit (ISA-ve) në trajtimin e sfidave për ruajtjen e mjeteve publike, zgjerimin e qeverisjes së korporatave, promovimin e transparencës, integritetit dhe llogaridhënies. Njëra prej mjeteve më efektive për trajtimin e këtyre sfidave ishte bashkëpunimi në mes të ISA-ve nën ombrellën e INTOSAI-t dhe organizatave të saj regjionale. Në fakt, INTOSAI është një organizatë autonome, e pavarur, profesioniste dhe jopolitike, e krijuar për t'u mundësuar ISA-ve anëtare të shkëmbejnë mendime, njohuri dhe përvoja. Kështu, ISA-të anëtare mund t'i zhvillojnë kapacitetet e tyre profesionale dhe t'i ndihmojnë qeveritë e tyre përkatëse në përmirësimin e performancës, promovimin e besimit të publikut, nxitjen e ekzekutimit efikas dhe efektiv të buxhetit dhe menaxhimit e kujdesshëm të fondeve publike, në dobi të qytetarëve të tyre.

Gjatë Kryesimit të Bordit Drejtues të INTOSAI-t (2017-2019) nga Emiratet e Bashkuara Arabe, në Kongresin XXIII u miratua vendimi i Bordit Drejtues për pranimin e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si anëtare me të drejta të plota në INTOSAI nga data 01.01.2020. Nga ky vendim pritet që ZKA-së së Kosovës t'i mundësohet shkëmbimi i njohurive dhe përvojave me ISA-të simotra dhe zhvillimi i ekspertizës profesionale, ndërtimi i kapaciteteve, ashtu që ISA-ja e Kosovës të mund të nxisë zhvillimin cilësor të rezultateve të saj dhe të rrisë njohuritë e palëve të interesit në të kuptuarit e rolit dhe përgjegjësisë të ZKA-së, si një institucion publik i pavarur.

Duke qenë anëtare me të drejta të plota në komunitetin e INTOSAI-t, ISA-të mund të forcojnë marrëdhënien dhe bashkëpunimin, si në nivel të dyanshëm, ashtu edhe në atë të shumanshëm dhe regjional, për të shkëmbyer pikëpamje dhe përvoja me vendet tjera në përdorimin e standardeve ndërkombëtare të auditimit, në sektorin publik. Me moton e INTOSAI-t “Të gjithë përfitojnë nga përvoja e ndërsjellë”, nga ZKA-ja e Kosovës pritet që të jetë një anëtare aktive, të ndajë dhe përfitojë përvoja me ISA-të e tjera anëtare”.

Institucionet Supreme të Auditimit

luajnë një rol kyç në shoqëritë demokratike



Vitor Caldeira

*President i Gjykatës së Auditorëve të Portugalisë
ish-President i Gjykatës Evropiane të Auditorëve (2008 – 2017)*

"Institucionet Supreme të Auditimit (ISA-të) luajnë një rol kyç në shtetet demokratike. Zakonisht, rëndësia e Institucioneve Supreme të Auditimit theksohet në sigurimin e ligjshmërisë dhe arsyeshmërisë në menaxhimit publik. Ky realitet nuk mund të jetë i ndarë nga promovimi i llogaridhënies së përfaqësuesve politikë, e cila rrjedh nga parimi demokratik.

Në një demokraci përfaqësuese, pushteti politik ushtrohet në emër të popullit dhe për popullin, përmes përfaqësuesve të zgjedhur nga vet ata. Njëherësh, përfaqësuesit politik duhet t'i japin llogari pikërisht atij populli.

Në një shoqëri demokratike, llogaridhënia dhe transparencja janë elemente kyçe për të nxitur besimin e qytetarit në qeverisjen publike. Për këtë, është e nevojshme të dihet se çfarë është arritur përmes politikave publike, si dhe ku e si përdoren paratë e taksapaguesve. Ekziston një lidhje e qartë mes demokracisë dhe burimeve publike, të cilat duhet të shpenzohen për interesin e qytetarëve, në mënyrë që të përmirësohet mirëqenia e tyre dhe e gjeneratave të ardhshme.

Bazuar në mandatet e tyre dhe përmes punës së tyre, ISA-të mund të kontribuojnë në menaxhimin e shëndoshë të parasë publike dhe në nxitjen e llogaridhënies nga menaxherët në sektorin publik. Puna e ISA-ve është e rëndësishme edhe për ushtrimin e kontrolleve të tjera demokratike. Duke i publikuar raportet e tyre, ISA-të i ofrojnë informacion të dobishëm shoqërisë lidhur me rezultatet e punës së tyre në auditim, duke promovuar kështu kontrollin e shoqërisë ndaj menaxhimit në sektorin publik. Informacioni i shpalosur nga ISA-të është njëkohësisht një kontribut i rëndësishëm për ushtrimin e kontrollit parlamentar ndaj ekzekutivit. Këto kontrolle janë shprehje e baraspeshës, e cila është e nevojshme në çdo sistem demokratik.

Çdo ISA i ka veçoritë e saj, bazuar në mandatin e tyre mandatin të saj dhe veçantive të secilit vend. Kjo është arsyeja se pse shkëmbimi i përvojave mes komunitetit të ISA-ve është kaq i rëndësishëm dhe i vlefshëm. Nën ombrellën e INTOSAI-t, ISA-të kanë mundësinë të shkëmbejnë përvojat dhe njohuritë e tyre lidhur me auditimin publik, nga i cili përfitojnë të gjithë. Kjo arrihet, për shembull, përmes grupeve të punës ku diskutohen çështje specifike dhe ku miratohen dokumente udhëzuese të rëndësishme. Bashkëpunimi ndërkombëtar kontribuon në forcimin e ISA-ve. ISA-të e fuqishme dhe të pavarura janë të domosdoshme për një demokraci të shëndoshë.

Ashtu siç është pranuar edhe nga Kombet e Bashkuara, ISA-të luajnë një rol të rëndësishëm për promovimin e efikasitetit, llogaridhënies, efektivitetit dhe transparencës në administratën publike, të cilat shpesh në arrijnë

e objektivave dhe prioriteteve kombëtare për zhvillim, si dhe të synimeve për zhvillim të pranuar ndërkombëtarisht. Për këtë qëllim, Kombet e Bashkuara inkurajojnë shtetet anëtare dhe institucionet e tyre përkatëse që të vazhdojnë dhe intensifikojnë bashkëpunimin e tyre me INTOSAI-n, gjegjësisht në aktivitetet për ndërtimin e kapaciteteve, në mënyrë që të promovojnë qeverisje të mirë përmes ISA-ve të fuqishme.³

Urime Kosovë. Mirësevjen në komunitetin e INTOSAI-t



Helena Lindberg
Auditore e Përgjithshme
Zyra Kombëtare e
Auditimit e Suedisë

“Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) ofron një platformë profesionale mbi bazën e së cilës, ne, Institucionet Supreme të Auditimit (ISA-të), të bashkojmë përpjekjet, të përballojmë sfidat dhe të zhvillohemi më tej në kuadër të mundësive tona. Si anëtare e INTOSAI-t, ju do të mund të përfitonit plotësisht nga kjo bashkëpjesëmarrje mes kolegësh, por edhe komuniteti i INTOSAI-t do të përfitojë nga përvojat e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës.

Standardet dhe udhëzuesit e hartuar nga INTOSAI për ISA-të na shërbejnë ne të gjithëve për kryerjen e auditimeve cilësore dhe në mënyrë profesionale, duke bërë kështu që besimi i palëve tona të interesit në punën tonë të rritet. Shoqëria kosovare do të përfitojë nga këto auditime më profesionale, të cilat ofrojnë transparencë dhe llogaridhënie për veprimet në sektorin publik. Kur ISA-ja vepron në pajtim me standardet ndërkombëtare, si qytetarët, ashtu edhe komuniteti ndërkombëtar mund të mbështeten në raportet e auditimit, ku jepet informacion i drejtë dhe i vërtetë mbi punën në sektorin publik. Anëtarësimi në INTOSAI do t'i japë edhe më shumë mundësi Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës për të përmbushur misionin e saj.

Puna me kolegë nga e gjithë bota do t'i ofrojë Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës mundësinë për të mësuar nga të tjerët, të ndajë me ta ekspertizën e saj, si dhe të jetë pjesë e zhvillimeve të reja. Kjo është përparësia e të qenit pjesë e një komuniteti, , motoja e të cilit është “Të gjithë përfitojnë nga përvoja e ndërsjellë”. Pikërisht në këtë frymë Zyra Kombëtare e Auditimit e Suedisë është bërë pjesë e udhëtimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës, që nga fillimet e saj. Si partner i juaji prej kohësh, ne i kemi ndjekur zhvillimet e juaja, suksesi i të cilave tashmë njihet edhe nga komuniteti i INTOSAI-t.

Në emër të kolegëve të mi në Zyrën Kombëtar të Auditimit të Suedisë, ju dëshiroj suksese në rrugëtimin tuaj dhe uroj që bashkëpunimi jonë të vazhdojë më tej, tashmë edhe përmes forumeve të INTOSAI-t”.

³ Rezoluta 66/209 e miratuar nga Asambleja e përgjithshme e KB me 22 dhjetor 2011 dhe Rezoluta 69/228 e miratuar nga Asambleja e përgjithshme e KB me 19 dhjetor 2014.

INTOSAI – inspirim profesional për Kosovën



Marian Banaś

*President i Zyrës Supreme
të Auditimit të Polonisë*

“Bashkëpunimi mes Zyrës Supreme të Auditimit të Polonisë (NIK) dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës daton që nga 2014, kur ZKA-ja filloi aktivitetet e ndryshme në kuadër të Komitetit kontaktues të Gjykatës Evropiane të Auditorëve dhe Institucioneve Supreme të Auditimit të shteteve anëtare të BE-së dhe Institucioneve Supreme të Auditimit të Rrjetit të Kandidateve të BE-së dhe të Kandidateve Potencial.

Ky bashkëpunim është bërë edhe më i ngushtë në 2016, kur kolegët kosovarë na kanë përzgjedhur neve për t’u bërë partner në Projektin e Binjakëzimet, të mbështetur nga BE-ja, i cili është përqendruar në auditimin e ndërmarrjeve publike dhe ka vazhduar me një projekt tjetër të mbështetur nga BE-ja, implementimi i të cilit ka filluar në gusht 2019.

Ne e vlerësojmë shumë bashkëpunimin bilateral dhe jemi të nderuar që e kemi përkrahur aplikimin e ZKA-së për anëtarësim në komunitetin më të madh ndërkombëtar të Institucioneve Supreme të Auditimit, INTOSAI.

INTOSAI është vendtakimi i Institucioneve Supreme të Auditimit, nga e gjithë bota. Për momentin, numri i anëtareve të tyre arrin në 194, duke përfshirë ZKA-në, e cila nga janari 2020, është bërë anëtar i ri i INTOSAI-t.

INTOSAI është organizata kryesore e përcaktimit të standardeve për Institucionet Supreme të Auditimit. Ky institucion i ka zhvilluar standardet e INTOSAI-t (gjithashtu të quajtura ISA, të cilat janë pikë kryesore reference për Institucionet Supreme të Auditimit në nivel global. Poashtu, Bashkimi Evropian i referohet standardeve të INTOSAI-t kur diskutohen çështjet të lidhura me menaxhimin dhe kontrollin e financave publike me shtetet kandidate.

Por, INTOSAI nuk është vetëm autoriteti për përcaktimin e standardeve. Motoja e tyre “Bashkëpunimi i ndërsjellë sjellë përfitime për të gjithë” është ilustrim i shkëlqyeshëm i formave të ndryshme të bashkëpunimit brenda organizatës.

Përderisa Kongresi i INTOSAI-t dhe Bordi Qeverisës janë platformat, ku drejtorët ekzekutivë të Institucioneve Supreme të Auditimit janë prezent dhe aktiv, shumica e bashkëpunimeve në mes auditorëve bëhen brenda

komiteteve dhe grupeve punuese. Do t'i kisha cekur disa prej tyre: Komiteti për Standarde Profesionale të INTOSAI-t, Komiteti për Ndërtimin e Kapaciteteve, Grupi Punues i Auditimit të TI-s, Grupi Punues për Auditimin e Ambientit, Grupi Punues për Borxhin Publik, Grupi Punues për Luftimin e Korrupsionit dhe Pastrimin e Parave. si dhe shumë të tjerë.

Unë mendoj se Zyra Kombëtare e Auditimit, me stafin e saj të ri, profesional dhe entuziast do ta konsiderojë INTOSAI-n si një vend inspirues për të vepruar. Në njërin anë, auditorët e tyre do të kenë mundësi të takojnë kolegët nga e tërë bota, të diskutojnë, krahasojnë dhe mësojnë nga njëri-tjetri. Kurse, në anën tjetër, ata do të kenë mundësi t'i shkëmbejnë arritjet e tyre dhe të kontribuojnë në zhvillimin profesional të homologeve të tyre.

Edhe pse me moshë dhe madhësi modeste, Zyra Kombëtare e Auditimit, me shumë krenari, mund të ndajë përvojën e tyre të ndërtimit të kapaciteteve, legjislacionin e tyre modern, etiken e punës dhe kualitetin e tyre në kryerjen e auditimit.

Miqve tonë kosovarë u dëshiroj shumë suksese në INTOSAI".

Qëllimi kryesor i INTOSAI-t – nxitja e qeverisjes së mirë dhe përmirësimi i jetës së qytetarëve



Ivan Klešić

Auditor i Përgjithshëm i Kroacisë

I dashur z. Osmani, të nderuar kolegë në Zyrën Kombëtare të Auditimit në Kosovë,

Anëtarësimi në Organizatën Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) është një moment shumë i rëndësishëm për secilin ISA. INTOSAI nënkupton për institucionet e auditimit në të gjithë botën atë çka Kombet e Bashkuara nënkuptojnë për secilin shtet të saj – platformë globale bashkëpunimi për shkëmbimin e përvojave, hartimin e standardeve dhe udhëzuesve të auditimit dhe promovimin e ngritjes së kapaciteteve të të gjitha institucioneve të auditimit. Qëllimi kryesor i saj është të nxisë qeverisjen e mirë dhe të përmirësojë jetën e qytetarëve në të gjithë botën. Kjo është arsyeja se pse motoja e saj "Të gjithë përfitojnë nga përvoja e ndërsjellë" apo "Experientia mutual omnibus prodest" i përshtatet mirë kësaj organizate.

Rëndësia e këtij anëtarësimi qëndron në faktin se parimet e INTOSAI-t, siç e ka vërtetuar edhe koha, janë vërtitur gjithmonë rreth barazisë për të gjithë anëtarët dhe pjesëmarrjesit e tyre vullnetarë. Pavarësia e Institucioneve Supreme të Auditimit është gjithashtu pashmangshmërisht e lidhur me arritjen e pavarësisë së anëtarëve të tyre, të cilët përkufizohen si persona që duhet t'i marrin vendimet për Institucionin Suprem të Auditimit.

Zyra Shtetërore e Auditimit e Kroacisë është anëtare e kësaj organizate autonome, e pavarur, profesionale dhe apolitike që nga viti 1994. Që nga ajo kohë, ajo ka pasur mundësinë për të promovuar shkëmbimin e ideve, njohurive dhe përvojave me anëtarët e tjerë të INTOSAI-t; të merr pjesë në hartimin e standardeve dhe udhëzuesve të auditimit; t'i ofrojë mbështetje kolegiale ISA-ve të tjera; dhe të përmirësojë vazhdimisht performancën e saj.

Jam i bindur se ky anëtarësim do t'i sjellë të njëjtat vlera në punën e institucionit tuaj, duke ia bërë të mundur Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës që t'i ndihmojë qeverive të përmirësojnë performancën, të rrisin transparencën, të sigurojnë llogaridhënie, të ruajnë besueshmërinë, të luftojnë korrupsionin, të nxisin besimin e publikut dhe të promovojnë pranimin dhe përdorimin efikas e efektiv të burimeve publike në dobi të qytetarëve.

Me rritjen e pritshmërive që INTOSAI të ndihmojë Institucionet Supreme Auditimit të adresojnë sfidat lidhur me qeverisjen e vendit dhe të promovojnë llogaridhënien, lind edhe nevoja për përmirësimin e vazhdueshëm të strukturës së qeverisjes së INTOSAI-t, për të maksimizuar vlerat e saj dhe përfitimet e ISA-ve. Në këtë aspekt, jam i bindur se ZKA-ja e Kosovës do të bëhet një pjesë e rëndësishme e këtij mozaiku.

Me rritjen e pritshmërive që INTOSAI të ndihmojë Institucionet Supreme Auditimit të adresojnë sfidat lidhur me qeverisjen e vendit dhe të promovojnë llogaridhënien, lind edhe nevoja për përmirësimin e vazhdueshëm të strukturës së qeverisjes së INTOSAI-t, për të maksimizuar vlerat e saj dhe përfitimet e ISA-ve. Në këtë aspekt, jam i bindur se ZKA-ja e Kosovës do të bëhet një pjesë e rëndësishme e këtij mozaiku.

Një sukses i merituar për zyrën më të re të auditimit publik në botë



Bujar Leskaj

*Kryetar i Kontrollit të Lartë të
Shtetit Republika e Shqipërisë*

Më 24 shtator 2019, institucioni më i lartë i auditimit publik i Kosovës, Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) u pranua anëtare me të drejta të plota e INTOSAI-t, organizatës botërore të Institucioneve Supreme të Auditimit. Një sukses i merituar për zyrën më të re të auditimit publik në botë, me vetëm 17 vjet jetë.

Pavarësisht nga progresi i spikatur i ZKA-së në drejtim të dijeve në auditim, trajnimeve të shumta dhe projekteve që ajo ka zhvilluar me ISA-të partnere, integrimi i plotë i saj në gjirin e organizatës INTOSAI nuk ishte i lehtë. Ishte bindja e palëkundur në vlerat dhe domosdoshmërinë e integritetit të ZKA-së, si anëtare me të drejta të plota në INTOSAI.

Suksesi i ISA-së kosovare nuk është i rastësishëm. Ai është ngjizur përgjatë viteve të vështira të krijimit dhe rritjes së saj. Kjo arritje erdhi edhe si rezultat i punës me vlerë të trupës audituese të ZKA-së, të udhëhequr nga Auditori i Përgjithshëm, Besnik Osmani, në drejtim të reformimit të thellë të institucionit, njohjes së standardeve ndërkombëtare të fushës ISA-ve dhe aplikimit të tyre në praktikë, sidomos në auditimet financiare dhe të performancës. Një reformim i filluar nga një personalitet i auditimit suprem publik ndërkombëtar, Lars Lage Olofsson, ish- Këshilltar i Lartë i SIGMA-s (programi "Mbështetje për përmirësim në qeverisje dhe menaxhim", i financuar nga BE-ja dhe OECD), i cili e drejtoi Zyrën në Kosovë që nga viti 2009 i themelimit të saj dhe deri në vitin 2015.

Anëtarësimi me të drejta të plota i Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës, përbën pa dyshim jo vetëm suksesin më të madh në historinë e auditimit të jashtëm publik të Shtetit të Kosovës, por edhe një arritje në fushatën

e madhe të njohjes së institucioneve të Kosovës nga partnerët ndërkombëtarë. Ne si KLSH jemi krenarë për suksesin e sivëllait tonë në auditim, për të cilin jemi përpjekur të kontribuojmë modestisht. Marrëveshja me Zyrën e Auditimit të Kosovës ishte marrëveshja e parë ndërkombëtare që kam lidhur në shkurt të vitit 2012. Për mua personalisht ngelet marrëveshja më e veçantë dhe emocionuese.

Këto shtatë vjet e gjysmë kanë parë organizimin (nga të dyja institucionet tona) të dhjetëra seminareve, konferencave, tryezave dhe takimeve të përbashkëta të punës. Gjithçka është siguruar mbi bazat e një vullneti të fortë dhe të sqartë bashkëpunues nga të dyja palët. Me ISA-në e Kosovës, audituesit tanë kanë shkëmbyer eksperiencat në auditim. Kemi kryer auditime të përbashkëta të performancës, me nismën tonë ose në kuadrin e nismave të grupeve të punës të EUROSAT-t. Kemi botuar libra së bashku, zhvilluar analiza të përbashkëta pune, si dhe shkëmbyer manuale dhe udhëzues të ndryshëm në shqip për standardet ndërkombëtare të auditimit suprem ISSAI.

Rrugëtimi ynë me ZKA-në është i përbashkët. Ndajmë të njëjtat misione, vlera dhe synime për të ardhmen e institucioneve tona në familjen e ISA-ve të Bashkimit Evropian, në përpjekje të vazhdueshme për t'i ofruar qytetarëve tanë vlerë të shtuar në administrimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të parave të tyre si taksapagues. Ne do të vazhdojmë me auditime të përbashkëta në shumë fusha, pasi dy-tre projekte të iniciuara kanë ecur mirë.

Ju faleminderit INTOSAI!⁴

⁴ Pjesë e shkëputur nga shkrimi autorial i B. Leskaj, botuar në gazetën "Sot", më 5 tetor 2019.

Zyra Kombëtare e Auditimit e Kosovës ka bërë një udhëtim të mrekullueshëm gjatë dekadës së fundit



Magnus Lindell

*Ish-Zv.Auditor i përgjithshëm për
çështje ndërkombëtare (2012-2018)
Zyra Kombëtare e Auditimit e
Suedisë,*

"Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës ka bërë një udhëtim të mrekullueshëm gjatë dekadës së fundit. Ajo është zhvilluar, si në shkathhtësitë e stafit, ashtu edhe në aftësinë profesionale. ZKA-ja e Kosovës është zhvilluar edhe institucionalisht. Tani ajo udhëhiqet plotësisht nga stafit vendor dhe, falë performancës në rritje, palët vendore të interesit kanë pritshmëri të larta prej saj.

Pranimi në INTOSAI si anëtare me të drejta të plota është një moment shumë i rëndësishëm për ZKA-në e Kosovës. INTOSAI është komuniteti botëror i Institucioneve Supreme të Auditimit (ISA-ve), si dhe një arenë për të mësuar dhe diskutuar mes kolegëve. Miratimi i standardeve ndërkombëtare për auditim në sektorin publik i ka dhënë INTOSAI-t një pozicion komplet të ri dhe ka rritur rëndësinë e tij në nivel botëror .

Përfitimet e ZKA-së së Kosovës janë të dukshme. Pavarësisht dallimeve në kontekstet e tyre, ISA-të i përmbahen të njëjtit grup standardesh ndërkombëtare, si në kontekstin organizativ, ashtu edhe në atë teknik. Ftesa e ZKA-së së Kosovës ndaj ISA-ve të tjera për të bërë vlerësime kolegjiale rreth performancës së saj do t'i lejonte asaj që të caktonte pika referimi kundrejt praktikave më të mira ndërkombëtare. Të qenit pjesë e një dialogu ndërkombëtar për auditim do t'i ndihmojë ZKA-së së Kosovës që të vazhdojë të rritet profesionalisht dhe të ruajë kështu rëndësinë që ajo ka për palët e interesit.

Megjithatë, anëtarësimi në INTOSAI është një rrugë e dyanshme pasi ekzistojnë edhe obligime.

Së pari, ZKA-ja duhet të jetë një partner aktiv në komunitetin botëror të ISA-ve. ZKA-ja ka një histori suksesi për të treguar, si dhe përvoja që janë relevante për t'i shkëmbyer me të tjerët. Si një anëtare aktive, ZKA-ja do të japë kontributin e saj nën moton e INTOSAI-t "Të gjithë përfitojnë nga përvoja e ndërsjellë".

Së dyti, nga ZKA-ja pritet që të jetë një institucion model në vetë kontekstin e saj. Duke qenë ambasadore e auditimit në sektorin publik, ZKA-së i duhet të promovojë profesionalizmin, integritetin dhe transparencën në të gjithë organizatë..

E fundit, por jo nga rëndësia: ZKA-ja duhet të ruajë pavarësinë e saj. Standardet ndërkombëtare fillojnë pikërisht me konstatimin se pavarësia politike dhe administrative e ISA-ve është thelbësore për besueshmërinë e tyre. Në një mjedis politik të paqëndrueshëm, kjo mund të jetë një sfidë. ZKA-ja duhet vazhdimisht t'ua kujtojë palëve të saj të interesit se transparenca dhe integriteti janë thelbësore për qeverisjen demokratike. Për këtë arsye, një Institucion Suprem Auditimi i pavarur është më se i domosdoshëm".



SHTOJCAT

SHTOJCA A: INTOSAI

Të dhëna përmbledhëse për INTOSAI-n

INTOSAI



“Experientia mutua omnibus prodest”

INTOSAI është një organizatë autonome, e pavarur, profesionale dhe jopolitike, e cila është themeluar si institucion i përhershëm. Vepron si një organizatë “ombrellë” për komunitetin e auditimit të sektorit publik dhe ka status të posaçëm konsultativ me Këshillin Ekonomik dhe Social (ECOSOC) të Kombeve të Bashkuara.

Në përputhje me moton e INTOSAI-t, ‘Experimentia mutua omnibus prodest’ (Eksperienca e përbashkët ju shërben të gjithëve), shkëmbimi i përvojave në mesin e anëtarëve të INTOSAI-t është një garanci për zhvillimin e auditimit publik.

INTOSAI u themelua në vitin 1953 në Havana të Kubës, me iniciativën e Emilio Fernandez Camus, presidenti i atëhershëm i ISA-s së Kubës. Fillimisht, numëronte 34 Institucione Supreme të Auditimit, kurse deri në vitin 2010 në kuadër të organizatës u anëtarësuan edhe 188 Institucioneve Supreme të Auditimit dhe Gjykata Evropiane e Auditorëve. Përveç anëtarëve fuqiptotë me Statut është paraparë edhe pjesëmarrja e anëtarëve të asociuar dhe këtu aktualisht hyjnë pesë organizata pa

të drejtë vote, përfshirë Bankën Botërore dhe Institutin e Auditorëve të Brendshëm.

Roli dhe kontributi i Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) është vendimtar në funksionimin dhe përparimin e auditimit publik në nivel botëror. Aktualisht, kjo organizatë përbëhet nga 194 Institucione Supreme të Auditimit, përfshirë ZKA-në. Në kuadër të kësaj organizate, funksionojnë edhe shtatë grupe regjionale të ISA-ve, siç janë:

- AFROSAL: Organizata Afrikane e ISA-ve
- ARABOSAL: Organizata Arabe e ISA-ve
- ASOSAL: Organizata Aziatike e ISA-ve
- CAROSAL: Organizata e ISA-ve të Karaibeve
- EUROSAL: Organizata Evropiane e ISA-ve
- OLACEFS: Organizata e ISA-ve të Amerikës Latine dhe Karaibeve
- PASAI: Asociacioni Pacifik i ISA-ve.

MISIONI DHE QËLLIMET

INTOSAI-i ka për qëllim të ofrojë mbështetje të ndërsjellë për anëtarët, të nxis shkëmbimin e ideve, njohurive dhe përvojave, të veprojë si një zë publik i njohur i ISA-ve brenda bashkësisë ndërkombëtare, të vendosë standarde për auditimin e sektorit publik, të promovojë qeverisjen e mirë kombëtare, si dhe të mbështesë zhvillimin e kapaciteteve, bashkëpunimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të performancës.

VIZIONI

INTOSAI promovon qeverisjen e mirë, duke u mundësuar ISA-ve të ndihmojnë qeveritë e tyre përkatëse në përmirësimin e performancës, fuqizimin e transparencës, sigurimin e përgjegjshmërisë dhe ruajtjen

e besueshmërinë, luftimin e korrupsionit, promovimin e besimit dhe nxitjen e përdorimit efikas dhe efektiv të burimeve publike në dobi të qytetarëve.

Organet e INTOSAI-t janë Kongresi, Bordi Drejtues dhe Sekretariati.

Kongresi i INTOSAI-t është organi suprem i organizatës dhe është i përbërë nga të gjithë anëtarët e plotë, të asociuar dhe bashkëpunëtorë. Kongresi mbledhet çdo tri vjet dhe thirret nga titullari i Institucionit Suprem të Auditimit të vendit në të cilin mbahet Kongresi.

Bordi Drejtues i INTOSAI-t - përbëhet nga 21 anëtarë dhe si rregull, mbledhet në baza vjetore ndërmjet Kongreseve. Për të siguruar përfaqësim të balancuar të të gjitha vendeve anëtare, secilap prej shtatë organizatave rajonale të punës së INTOSAI-t, si dhe llojet kryesore të sistemeve publike të auditimit janë të përfaqësuara në Bord.

Sekretariati i Përgjithshëm siguron mbështetje administrative dhe strategjike për organizatën. Sekretariati i Përgjithshëm drejtohet nga Kryetari i Gjykatës Austriake të Auditimit, si Sekretar i Përgjithshëm i INTOSAI-t.

SELIA

Selia e INTOSAI-t dhe Sekretariatit të Përgjithshëm është në Vjenë, Austri, e vendosur në selinë zyrtare të Gjykatës së Auditimit të Republikës së Austrisë.

STANDARDET E FUNKSIONIMIT TË AUDITIMIT TË SEKTORIT PUBLIK TË LËSHUARA NGA INTOSAI

INTOSAI është angazhuar vazhdimisht për ndërtimin e kapaciteteve dhe strukturave të nevojshme, për të siguruar një sërë standardesh ndërkombëtare për auditimin e sektorit publik. Këto standarde përcaktojnë pa-

rimet e përgjithshme dhe postulatet për kryerjen e funksionit të auditimit të sektorit publik.

Deklarata e Limas (INTOSAI – P 1), e aprovuar gjatë Kongresit të IX-të të INTOSAI-t të mbajtur në Lima të Perusë në vitin 1977, konsiderohet si “makina kryesore” e auditimit publik dhe përcakton karakteristikat dhe kërkesat për pavarësinë dhe funksionimin efektiv të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISA).

Derisa, Deklarata e Meksikës (INTOSAI – P 10) mbi pavarësinë e ISA-ve përcakton saktë tetë parimet bazë të pavarësisë, të nevojshme për ISA-të për auditim e sektorit publik:

- Korniza efektive ligjore;
- Pavarësia, duke përfshirë sigurinë e mandatit;
- Mandati i gjerë dhe liria e veprimit në ushtrimin e funksioneve të ISA-s;
- Qasja e pakufizuar në informata;
- Të drejtat dhe detyrimet për të raportuar mbi punën e auditimit të paktën çdo vit;
- Liria për të vendosur mbi përmbajtjen dhe kohën e raporteve të auditimit;
- Mekanizmat efektiv për t’i përcjellë rekomandimet e ISA-s;
- Autonomia financiare e ISA-s.

Vlen të theksojmë se korniza ligjore e Kosovës i ka përfshirë këto kërkesa të INTOSAI-t në Kushtetutë, si aktin më të lartë juridik, si dhe ligjin organik për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit.




FOTO GALERIA



**Abdurrahmon
Bërbatovci**
Auditor Junior



Adelina Selmani
Auditor Senior



Adem Sylejmani
Udhëheqës i Departamenti
për Buxhet dhe Burime
Njerëzore



Agim Sogojeva
Auditor Senior



Agron Fetiu
Auditor Specialist



Agron Hoxha
Auditor Junior i
Performances



Aida Podrimaj
Auditor Senior



Ajtene Llapashtica
Auditor Senior



Alba Keqa
Auditor Junior i
Performances



Alban Beka
Auditor Junior



Alban Shatri
Auditor Junior



Albana Kadriu Zogjani
Auditor Junior



Albesa Tolaj Ramosaj
Auditor Senior



Antigona Çitaku
Auditor Junior



Arben Hundozi
Auditor Junior



Arben Selimi
Auditor i Performances



Arberore Sheremeti
Auditor i Teknologjisë
Informative



Ardiana Miftari
Auditor Junior i
Performances



Ardiana Sahiti
Udhëheqës i Auditimit të
Brendshëm



Ardita Gashi Billaca
Zyrtare e Burimeve
Njerëzore



Ardita Salihu
Auditor Senior



Arian Haxha
Auditor Senior



Arian Zenelaj
Auditor Junior



**Ariana Berisha
Rexhëbeqaj**
Auditor Senior



**Ariana Gjonbalaj
Shala**
Auditor i Performances



**Arlinda Mustafa
Selmani**
Auditor Junior i
Performances



Armend Salihu
Auditor i Teknologjisë
Informative



Armin Bushati
Auditor Junior i
Performances



Arnisa Aliu
Auditor Junior



Arta Kryeziu Qehaja
Auditor



Arta Birinxhiku
Auditor Senior



Arvita Zyferi Hashani
Ndhmës Auditor i
Përgjithshëm



Astrit Billaca
Udhëheqës i
Departamentit të Auditimit



Aurora Morina
Auditor Junior



Bahri Statovci
Auditor Senior



Besa Morina Gega
Auditor Senior



Besim Lezi
Auditor Senior



Besnik Osmani
Auditor i Përgjithshëm



Blerim Kabashi
Udhëheqës i
Departamentit të Auditimit



**Blerina Krasniqi
Himaj**
Auditor Senior



Bujar Bajraktari
Udhëheqës i
Departamentit të Auditimit



Burbuqe Idrizi Ukaj
Auditor Senior



Dafina Strana Ujkani
Udhëheqëse e Divizionit të
Burimeve Njerëzore



Dardane Neziri
Këshilltare e Auditorit të
Përgjithshëm



Demir Reshiti
Përkthyes



Donjetë Dreshaj
Auditor



Drilon Shala
Auditor Senior i
Performances



Drita Çunaku
Udhëheqëse e Divizionit
për Administrimin e
Dokumente



Driton Hashani
Zyrtar i lartë i rrjetit të IT



Edon Kabashi
Auditor Senior



Edona Abazi Demolli
Auditor Senior



Ejup Simnica
Auditor Senior



Elira Hashani
Auditor Junior i
Performances



Elvir Krasniqi
Auditor



Emine Fazliu
Ndhmës Auditor i
Përgjithshëm



Enver Ramadani
Auditor Senior



Enver Boqolli
Udhëheqës i
Departamentit të Auditimit



Erëmira Bytyqi Pllana
Auditor



Ernes Beka
Auditor



Faik Thaqi
Auditor Senior



Fanol Hodolli
Auditor



Faruk Rrahmani
Udhëheqës i
Departamentit të Auditimit



Fatlije Gjonbalaj
Përkthyes



**Fatlinda Podvorica
Kabashi**
Auditor Junior



**Fatlinda Ramosaj
Miroci**
Udhëheqës i
Departamentit të Auditimit



Fatmir Uka
Udhëheqës për Shërbime
të Përbashkëta



Fejzullah Fejza
Auditor Senior



Fetah Osmani
Auditor Senior



Fexhrie Thaqi
Auditor Junior i
Performances



Fikret Ibrahim
Auditor Senior i
Performances



Fisnik Rudaj
Auditor Junior



Fitim Haliti
Udhëheqës i
Departamentit të Auditimit



Fjolla Bakalli Sadiku
Auditor Senior



**Fjoralba Kokonozi
Sylaj**
Udhëheqëse e Divizionit të
Përkthimeve



**Florë Berisha
Kutllovci**
Auditor



Florim Beqiri
Udhëheqës i
Departamentit të Auditimit



Florim Maliqi
Auditor Senior



**Ganimete Dalloshi
Hoxhaj**
Auditor Senior



Gazmend Namani
Auditor Junior



Hamit Emini
Vozitës



Hysen Boqolli
Auditor Senior



Hysen Restelica
Auditor Junior



Igballë Halili
Auditor Senior



Ilir Salihu
Zëvendës Auditor i
Përgjithshëm



Ilir Abazi
Auditor Senior



Imer Vitija
Auditor Specialist



Imri Semetishti
Drejtör i Përgjithshëm
Administrativ



**Jehona Krasniqi
Rexha**
Auditor Junior



Jetmira Isufi
Auditor Senior



Jusuf Kryeziu
Auditor Senior



Kapllan Muhaxheri
Auditor Specialist



Krenare Pirana Kiseri
Auditor Senior



**Kreshnike Haziri
Publica**
Auditor



Labinot Sadiku
Auditor i Performances



**Laureta Matoshi
Pozhegu**
Auditor Senior



Lavdim Maxhuni
Auditor Senior



Leonora Hasani
Auditor Junior



**Leonore Krasniqi
Jashari**
Zyrtare e lartë Ekzekutive



Lindita Ajeti Dobruna
Auditor



**Liridona Berisha
Kelmendi**
Auditor Senior



Luljeta Sylaj
Auditor Senior



Luljeta Berisha
Udhëheqës i
Departamentit të Auditimit



Luljete Osmani
Udhëheqës i Divizionit për
Buxhet dhe Financa



Lumturije Sopi
Auditor Junior



Mazlumsha Sejjadini
Auditor Senior



Mehmet Kurti
Auditor



Mehmet Muçaj
Auditor Senior



Mergim Hoti
Përkthyes



Mexhit Ferati
Auditor Senior



Miloš Petrović
Auditor



Mimoza Damoni Beqa
Udhëheqës i Departamenti
për TI



**Mimoza Morina
Kelani**
Auditor Junior



Mirlinda Beqiri
Auditor Senior



Mjellma Dibra Morina
Auditor Senior



Muhamet Balaj
Auditor



Muharrem Qyqalla
Auditor Junior



Mujë Gashi
Udhëheqës i Departamentit për Metodologji dhe Kontroll të Cilësisë



Myrvete Gashi Morina
Udhëheqës i Departamentit të Auditimit



Naim Neziri
Auditor



Naser Arllati
Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Natyra Kasumaj Ahmeti
Kordinatore e Njesisë kundër Mashtrimit



Nebojša Ristić
Auditor



Neslihan Mati
Auditor



Nexhmi Jashanica
Zyrtar për Logjistikë dhe Transport



Nora Rashiti Nishefci
Auditor



Nuhi Dili
Mirëmbajtës i Objektit



Pleurat Isufi
Auditor



Poliksena Berisha
Auditor i Teknologjisë Informative



Qëndresa Isufi
Auditor



Qendresë Mulaj
Udhëheqëse e Kabinetit të Auditorit të Përgjithshëm



Qerkin Morina
Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Ramadan Gashi
Auditor Specialist



Refiqe Morina Bytyqi
Auditor



Riza Spanca
Auditor Specialist



Sabile Musa
Auditor Senior



Safet Berisha
Udhëheqës i Departamentit për Çështje Juridike në Auditimit



Samir Zymberi
Udhëheqës i Departamentit të Auditimit



Saranda Husaj Baraliu
Udhëheqës i Departamentit për Komunikim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar në Auditim



Selami Ibishi
Zyrtar për Administrimin e rrjetit dhe sistemit të TI



Selvete Foniqi
Auditor



Senver Morina
Auditor Senior



Shefkije Beka Gervalla
Auditor Senior



Shehrije Shala Aliu
Auditor Senior



Shemsije Llugiqi
Auditor Senior



Shkëlqim Xhema
Udhëheqës i
Departamentit të Auditimit



Shkurta Stublla
Auditor Junior i
Performances



Shpresa Zenelaj Krasniqi
Auditor



Shpresa Hasani Hasanramaj
Asistent ekzekutive e
Auditorit të Përgjithshëm



Shqipe Mujku Hajrizi
Auditor i Teknologjisë
Informative



Shqipe Azemi
Specialist i TIK



Shqipe Hetemi
Zyrtar për Informim dhe
Monitorim të Mediave



Shqiponja Krasniqi
Auditor



Stana Dančetović
Auditor Senior



Svetlana Perović
Auditor



Syeda Oruqi
Zyrtar Certifikues



Valbona Tolaj
Auditor Senior



Valbona Pllana Sadriu
Auditor



Valmira Jonuzi Hamzaj
Auditor



Veton Misiri
Auditor Senior



Violeta Smajlaj
Zyrtare e lartë ndërlidhëse
me Kuvendin dhe
Integritet Evropiane



Vjosë Bojku
Auditor Junior i
Performancës



Vlora Spanca
Ndihmës Auditor i
Përgjithshëm



Vlora Duraku
Auditor Senior



Xhemile Berisha Hoti
Auditor



Xhevhat Krasniqi
Vozitës



Xhevhat Hasolli
Zyrtar i Financave



Xhevhat Seferi
Auditor Senior



Ylber Sadiku
Auditor



Ylfete Osmani
Auditor i Performancës



Zukë Zuka
Udhëheqës i
Departamentit të
Auditimit

INTEGRIMI NDËRKOMBËTAR I
ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT

"Under the motto of the International Organisation of Supreme Audit Institutions "Mutual experience benefits all" the National Audit Office of Kosovo is expected to be an active member and share and benefit experience with other SAI's members"

Dr. Harib ALAMIMI

*Former President of INTOSAI (2017-2019)
President of SAI of United Arab Emirates*

"Each Supreme Audit Institution has its own particularities, related to its mandate and to the specificities of the respective country. This is why it is so important and enriching sharing experiences among the SAI community. Under the umbrella of INTOSAI, SAI's have the opportunity to share experiences and knowledge about multiple issues related to public audit, which benefit all"

Vitor CALDEIRA

*Former President of the European Court of Auditors (2008-2017)
President of Court of Auditors of Portugal*

"Working with colleagues from all over the world will offer Kosovo National Audit Office an opportunity to learn from others, share their own expertise and be part of new developments. This is the strength of being part of a community. As a long standing partner we have followed your developments, the success of which has now also been recognized by the International Organisation of Supreme Audit Institutions (INTOSAI) community"

Helena LINDBERG

Auditor General, Swedish National Audit

"Kosovo National Audit Office, with its young, professional and enthusiastic staff, will find INTOSAI an inspiring place to be. On the one hand, its auditors will be able to meet colleagues from all around the world, discuss, compare and learn things from one another. On the other hand, they will be able to share their achievements and contribute to the development of their counterparts"

Marian Banaś

President of the Supreme Audit Office of Poland

"I am convicted that this membership will bring the same values to work of your Institution, enabling National Audit Office of Kosovo to help governments improve performance, enhance transparency, ensure accountability, maintain credibility, fight corruption, promote public trust, and foster the efficient and effective receipt and use of public resources for the benefit of the citizens"

Ivan Klešić

Auditor General of Croatia

"The full membership of the Kosovo National Audit Office is undoubtedly not only the greatest success in the history of the public external audit of the State of Kosovo, but also an achievement in the campaign for worldwide recognition of Kosovo's institutions by international partners. We, as Albanian Supreme Audit Institution (ALSAI), are proud of our brother SAI's success in auditing, to which we have tried modestly to contribute"

Bujar Leskaj

*President of the Supreme Audit Institutions
Republic of Albania*

"The Kosovo National Audit Office has made a remarkable journey over the last decade or so. It has grown both in staff strength and in professional capability. KNAO has also matured institutionally. It has now a fully national leadership and – thanks to its increasing performance – high expectations from national stakeholders"

Magnus Lindell

Former Deputy Auditor General of Sweden

